



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Ilir META

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2014**

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Ndërgjegjësimit dhe rritjes së besimit të publikut në rolin e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës, e shprehur nëpërmjet rritjes së numrit të çështjeve të ankimuara pranë Autoritetit të Konkurrencës.

- Rritjes së numrit të ndërhyrjeve në treg dhe zgjerimit të llojeve të tregjeve, të cilat kanë qenë objekt i monitorimit dhe hetimeve në zbatim të ligjit.

- Konsolidimit të institucionit të konkurrencës nëpërmjet përmirësimit të nivelit të ekspertizës dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, si një nga faktorët kryesorë për pavarësinë reale të institucionit të konkurrencës.

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, duke synuar përafrimin me standardet ndërkombëtare, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2015, të përmirësojë punën në drejtim të:

- Monitorimit në mënyrë të vazhdueshme të tregjeve prioritare, që kanë qenë objekt hetimi apo monitorimi nga Autoriteti i Konkurrencës më parë si: tregu i telefonisë celulare, tregu i importit dhe shitjes me shumicë të gazit, tregu i sigurimeve, tregu i karburanteve, tregu i energjisë, tregu i shërbimit të transportit ajror, tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, për të ndjekur sjelljen e firmave në treg.

Ndjekja në vazhdimësi është e rëndësishme për të mundësuar zbatimin konkret të rekomandimeve të dhëna, me qëllim vendosjen dhe ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në këto tregje.

- Shpeshimit të inspektimeve në formën “*Dawn raids*” me nismën e vetë Autoritetit në tregjet me kërkesa cilësore e të ndjeshme ndaj shpenzimeve konsumatore, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e praktikave antikonkurrese.

- Angazhimit në vazhdimësi në procese trajnimi të gjyqësorit administrativ të të gjitha shkallëve për të thelluar njohuritë në fushën e së drejtës së konkurrencës, për të mundësuar një rishikim gjyqësor sa më objektiv në interesin publik të vendimeve të Autoritetit dhe të konkurrencës, si një e mirë publike, duke qenë se eficienta e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij.

- Nxitjes së mëtejshme të përhapjes së advokacisë e kulturës së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit proaktiv, me anë të aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin e biznesit, për të vlerësuar perceptimin e biznesit mbi nivelin e njohjes së filozofisë së konkurrencës dhe zbatimit të ligjit e për të siguruar që veprimtaria e tyre të jetë në përputhje me rregullat e konkurrencës.

- Forcimit të rolit të institucionit si mbrojtës i interesave të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit të akteve, që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

- Për të paraqitur në kohën e duhur pranë Autoritetit të Konkurrencës gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për monitorimin e tregjeve apo hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg.

Miratuar në datën 30.4.2015